



V E N D I M
Nr. 52 Datë 09.05.2008

**PËR NJE SHTESE NE VENDIMIN NR 46 DATE 10.08.2007 “ PER
PERCAKTIMIN E VLERES SE GJOBAVE DHE LLOGARITJES SE DEMIT QE
DO TE APLIKOHEN NDAJ KLIENTEVE ME KUNDRAVAJTJE NE PERDORIMIN
E ENERGJISE ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 46/1, pika 3, të Ligjit nr. 9072, dt 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit te Bordit te Komisionereve nr. 38, date 21.03.2008, “Per Fillimin e procedurave për nje shtese ne Vendimin nr.46, date 10.08.2007 “Per percaktimin e vleres se gjobave dhe llogaritjes se demit qe do te aplikohen ndaj klienteve me kundravajtje ne perdorimin e energjise elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09/05/2008 pasi diskutoi mbi menyren e llogaritjes se demit te shkaktuar nga konsumatorët ne kundravajtje te perdorimit te energjise elektrike,

Vendosi :

1.Në vendimin nr.46 datë 10.08.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Per percaktimin e vleres se gjobave dhe llogaritjes se demit qe do te aplikohet ndaj klienteve me kundravajtje ne perdorimin e energjise elektrike” pas pikes 2 shtohet pika 3 me permbajtjen:

3. Per konsumatorët familjare dhe jofamiljare ne kundravajtje te perdorimit te energjise elektrike, ne rastet kur çmimi i shitjes se energjise elektrike eshte i ndryshem ne varesi te sasise se konsumit apo te kohes se konsumit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



sasia e kwh te faturuar si dem te llogaritet bazuar ne çmimin maksimal te shitjes se energjise elektrike ne perputhje me kategorine e konsumatorit.

2. Ngarkohet KESH sh.a per zbatimin e ketij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftoj KESH sh.a per vendimin e Bordit te Komisionereve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta